

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 3992 Rep.  
Nr. 121 Kol



### KONTRATE DHURIMI VULLNETAR (AKSIONESH)

Sot më datë 15 shtator 2004 (dymijë e katër), para meje noteres Qamile Shehu, me studio në rrugën Islam Alla 138 në Tiranë, tel. 042 55467, u paraqitën personalisht palët si më poshtë:

#### DHURUES TE AKSIONEVE:

1.DRITA LAHI, bija e Rizait dhe e Merjemes, lindur më 18.01.1945 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga Komuna e Parisit, Pallatet HAWAI, Kulla I Kati IV, mbajtëse e letërnjoftimit NF Nr. 358933;

2.SONILA LAHI (para martese SONILA MUÇO), bija e Refatit dhe e Donikës, lindur më 10.01.1975 në Durrës dhe banuese në Tiranë, rruga Komuna e Parisit, Pallatet HAWAI, Kulla I Kati IV, mbajtëse e pasaportës nr. Z 0592155;

#### PRANUES I AKSIONEVE:

1.HERION LAHI, i biri i Zahitit dhe i Dritës, lindur më 16.02.1974 në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rruga Komuna e Parisit, Kompleksi Hawaii, Kulla I, kati IV, i pajisur me pasaportën nr. Z1028972;

që të gjithë madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Të sipërpërmendurit deklaruan:

Sipas Raportit mbi shpërndarjen e aksioneve të shoqërisë Albania Mobile Communication, Qendra AKP TIRANE (ekstrakteve të regjistrimit të aksioneve), të sipërpërmendurit dhe i ndjeri Zahit Lahi kanë në zotërim aksione të kësaj Shoqërie si më poshtë:

1.ZAHIT	HASAN	LAHI	75 aksione me vlerë 75.000 lekë,
2.DRITA	RIZA	LAHI	75 aksione me vlerë 75.000 lekë,
3.HERION	ZAHIT	LAHI	50 aksione me vlerë 50.000 lekë,
4.SONILA	REFAT	LAHI	50 aksione me vlerë 50.000 lekë.

Sikundër provohet nga Certifikata e Vdekjes e lëshuar nga ZGJC e njësisë nr. 5 të Tiranës, më 25 shtator 2001 ka vdekur i ndjeri ZAHIT LAHI. Me Vendimin nr. 5326/3761 të datës 08.11.2001, Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka lëshuar Dëshminë e Trashëgimisë sipas të cilës zonja DRITA LAHI trashëgon të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësit ZAHIT LAHI (nga që blytë e të ndjerit, z. HERION LAHI dhe zj. Dezanila QUKU, kanë hequr dorë nga trashëgimia). Për pasojë, 75 (shtatëdhjetë e pesë) aksionet e zotit ZAHIT LAHI trashëgohen nga zonja DRITA LAHI.

Sot më datën 15 shtator 2004, të dy dhuruesit DRITA LAHI dhe SONILA LAHI, deklarojnë se me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, aksionet që zotërojnë në shoqërinë Albania Mobile Communication (si ato që zotërojnë vetë, ashtu edhe ato të zotit ZAHIT LAHI që trashëgohen nga zonja DRITA LAHI) ia dhurojnë që të gjitha, pa asnjë kusht dhe pa kundërshtëpërblim, zotit HERION LAHI, i cili e pranon këtë dhurim.

Me noterimin e kësaj kontrate dhurimi dhe me regjistrimin e saj në librin e aksioneve të Shoqërisë, dhuruesit zhvishen nga pronësia mbi aksionet që zotërojnë dhe nga aksionet që trashëgojnë nga i ndjeri ZAHIT LAHI dhe pronar i tyre bëhet zoti HERION LAHI, i cili pas këtij dhurimi (bashkë me aksionet që zotëronte para dhurimit) zotëron gjithsejt 250 (dyqind e pesëdhjetë) aksione të Shoqërisë me vlerë 250.000 lekë.

Kjo Kontratë hartohet në bazë të dispozitave përkatëse për dhurimin të Kodit Civil në 3 (tri) kopje me përmbajtje dhe fuqi të njëjtë ligjore. Palët deklaruan se kuptuan përmbajtjen e saj, pranojnë saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë e të plotë në prani të Noteres.

Unë Noterja e vërtetoj atë në bazë të Ligjës.

DHURUESIT  
DRITA LAHI

*Drita Lahi*

SONILA LAHI

*Sonila Lahi*

PRANUESI:

HERION LAHI

*Herion Lahi*

*HL*

NOTERE  
Qamile SHEHU

*Qamile Shehu*